



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 18-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 26.07.2023, në sallën numër 1, kati i 3-të, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Shkelzen Hajdini DSHPS
2. Latif Ramadani, DBF
3. Safet Krasniqi, Auditor i mbrëmshëm

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Behar Aliu*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë me kohë, dhe e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 17-të e KPF-së.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2023.

3. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2022.
4. Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Kosovës për vitin 2022, të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit.
5. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "PASTRIMI"SH.A.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se me kërkesë të drejtorit të shëndetësisë, pikën e fundit po e qesim të parën nëse pajtoheni ju anëtarët e KPF-së.

VI

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "PASTRIMI"SH.A.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit, nga DSHPS, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 17-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 16-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se pikat tjera të rendit të ditës pasi që janë raporte a dëshironi ti diskutoni apo doni që i dërgojmë për kuvend.

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2023,

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2022,

Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Kosovës për vitin 2022, të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 10:45

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi